

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare dhe gjyqtarëve Vjollca Buzhala dhe Nazim Vllaqo, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.B nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i informatës zyrtar nga neni 423 par.1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.856/16-II e datës 31.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Genc Nixha, të akuzuarit, mbrojtësit të tij av.H.K, të dëmtuarit dhe përfaqësuesi i autorizuar për të dëmtuarin D.H, av. E.G.G nga Prizreni, me datë 20.11.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**1.N.B**, nga i ati R.. dhe e ëma F., e lindur ..., i lindur më ... në ... ku edhe tani jeton në rr.” ...” p.nr. ka të kryer fakultetin e Shkencave Politike – Politika e Sigurisë , i punësuar pranë stacionit policor “...” në ... , i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar- shtetas i R. së Kosovës, me nr. personal ...

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.1 të KPP-së,

**LIROHET NGA AKUZA**

Se gjatë muajit tetor të vitit 2015 në Prizren, duke punuar në cilësinë e personit zyrtarë pranë Stacionit policor “...” në ..., me gradë rreshter i cili ka pas qasje në bazë të detyrës së tij në informacione, keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për personin tjetër të përfitoj ndonjë përparësi që nuk i takon, në atë mënyrë që duke vepruar në bazë të kërkesës së qytetares A.K, gjatë bisedave telefonike me te përmes rrjetit “viber” të njejtën e vë në dijeni për numrin e veprave penale dhe ato të kundërvajtjes të kryer nga i dëmtuari D.H, e të cilat konsiderohen si informatë zyrtare të cilat informacione më pas kanë ndikuar në prishjen e raporteve në mesë të dëmtuarit dhe qytetares A.K.

-me këtë do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i informatës zyrtare nga neni 423 par.1 të KP-së.

Sepse vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale.

I dëmtuari D.H për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civile.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departament për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.856/16-II e datës 31.10.2016, kundër të akuzuarit N.B nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i informatës zyrtare nga neni 423 par.1 të KP-së,

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar i akuzuari, i dëmtuari, dëshmitarët dhe eksperti i lëmis së caktuar si dhe janë administruar provat materiale, në bazë të cilave është vërtetuar gjendja faktike se në veprimet e të akuzuarit janë formuar elementet e veprës penale. I akuzuari ka pranuar se dëshmitarët A.K, të cilën e ka njohur më herët, i ka dërguar përmes rrjetit social facebook mesazh dhe ka njoftuar se i dëmtuari ka 37 vepra penale dhe kundërvajtje. Këtë fakt ka shpjeguar edhe dëshmitarja A.. e cila ka pohuar se ka kontaktuar me të akuzuarin N.. dhe qëllimi i saj ka qenë që informacionet që ka pas për të dëmtuarin ta vërteton dhe se nga i akuzuari ka marr një përgjigje se i dëmtuari ka 37 vepra penale. Dëshmitari Z.V ka dëshmuar se mesazhet të cilat i ka pranuar ai vetë i ka printuar dhe më pas i ka dërguar të dëmtuarit D.H e poashtu ka dëshmuar se D.H ka pas raporte dashurie me dëshmitaren A.. e cila ka shkëputur lidhjen me të dëmtuarin. Në bazë të deklaratës së ekspertit të IT-së dhe në bazë të raportit është vërtetuar se i akuzuari nuk ka pas qasje në data bazë të informacioneve mirëpo elementi i veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari është që informatën për të cilën ai ka qenë në dijeni ia ka dorëzuar për shërbim personave të tjerë për përdorim të jashtëm dhe se ky informacion është si rezultat i detyrës së tij të punës e cila nuk është bërë publike ndërsa i akuzuari përmes rrjetit social ka bërë publike duke ia dorëzuar informacionin dëshmitares A... Konsideron se gjykata nuk duhet të pranon mbrojtjen e të akuzuarit se numri 37 është vetëm një numër matematikore dhe se në mesazh nuk është përmendur vepra penale, se kjo është një kontakt privat me dëshmitaren dhe se mund të ekziston edhe mundësia që ky numër është kopja dhe se fare nuk ka të bëjë me bisedën, respektivisht kontaktin përmes SMS me A.. sepse këto janë tendencat të akuzuarit për shmangien nga përgjegjësia juridiko penale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. E.G.G në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorisë është ngritur mbi fakte dhe prova bindëse në bazë të deklaratës së të akuzuarit e dhënë në Prokurori, në bazë të bisedës e transkriptuar e zhvilluar përmes rrjetit Viber dhe Messenger në mesë të akuzuarit dhe dëshmitares A.K, veçanërisht biseda e datës 12.tetor 2016 dhe dëshmia e dëshmitarës A.K e dhënë në prokurori, dëshmitarit Z.V dhe raporti lidhur me qasjen në të dhëna në sistemin e lëshuar nga Qeveria MUB Policia e Kosovës , Drejtoria e Përgjithshme e datës 07.09.2017 është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet. Është vërtetuar se i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me nenin 423 të KPP-së si person zyrtarë ka keqpërdor informatën zyrtare me qëllim që për vete apo për personin tjetër të përfiton ndonjë përparësi që nuk i takon, në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 31 të Ligjit për Polici ku është i paraparë se mbledhja, ruajtja, procedimi, analizimi, përdorimi dhe fshirja e të dhënave par. 1, ku policia është i autorizuar ti mbledh dhe të ruan të dhënat personale të cilat kanë të bëjnë me një person të identifikuar apo të identifikueshëm që të fshinë , por nuk kufizohen në emër, ditëlindjen, vendin e lindjes dhe në vendbanim dhe se të dhënat e krimit janë të dhëna që kanë të bëjë me vepra të caktuar penale që përfshinë por nuk kufizohen në llojin e veprës penale, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, metodat dhe mënyrat e përdorura etj dhe par. 6 në bazë të cilit zyrtari policor ka për detyrë të ruaj besueshmërinë e të gjitha dhëna personale dhe të krimit të cilat ai i ka marr gjatë kryerjes së detyrave policore përveç në ato raste kur lirimi i të dhënave autorizohet me ligje dhe është e nevojshme për të arritur objektivin legjitim të policisë.

Ka shkelur nenin 7 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale të ndjeshme, ka vepruar në kundërshtim me shkeljet e UA nr. 04./2012 për standardet dhe metodat e nxjerrjes, ruajtjes, përdorimit dhe fshirjes së të dhënave nga policia andaj konsideron se obligimi i gjykatës është që mbroj ligjin dhe në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 365 të nxjerr aktgjykim fajësues për të akuzuarin dhe në kuptim të nenit 74 par. 1 dhe 2 pik. 2.2 dhe 2.9 gjatë vendosjes mbi dënimin të merr parasysh si rrethanë rënduese shkallën e dashjes nga ana e personit të dënuar , përfshirë çfarëdo provë të paramendimit si dhe çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit apo pozitës zyrtare duke pas parasysh se i akuzuari është rreshterë pranë Stacionit Policor në .... Në emër të dëmtuarit në kuptim të dispozitës ligjore 354 të KPPK parashtron kërkesë pasurore juridike dhe atë: në emër të dëmit material për marrjen e kredisë në shumë prej 18.000 € (me qëllim përgatitje për fejesë dhe martesë me A.K) dhe të gjitha veprime që i ka ndërmarë në zbardhje të rastit në fjalë, në shumën total prej 25.000 € dhe në emër të dëmit jo material dhimbje shpirtërore, cenin të dinjitetit dhe humbje reputacioni në shumë prej 10.000 € në shumë total prej 55.000 €.

I dëmtuari D.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës së dhënë nga ana e përfaqësueses duke precizuar se është i dëmtuar në disa aspekte, moralisht sepse ka mbetur pa grua respektivisht informata e policit ka shkaktuar që të prishen raportet me A., me të cilën ka pasur në planë për fejesë e pastaj edhe martesë, ekonomikisht sepse ka pasur shpenzime në zbulimin e rastit dhe sigurimin e provave, prej asaj kohe janë prishur raportet edhe brenda familjes respektivisht me babanë i cili nuk e pranon në dhomën ku ai qëndron, po ashtu ka pasur edhe shpenzime sepse ka marrë kredi në muajin maj për përgatitjen e fejesës në shumën prej 18.000 € të cilën kredi edhe sot nuk e ka paguar dhe ka probleme me përmbaruesit dhe përveç kësaj edhe nuk është i qetë në punë pasi që dy herë ka qenë në arrest prandaj nuk e respektojnë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.B av. H.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron se provat të cilat janë bashkangjitura aktakuzës janë nxjerrë nga një qytetar i paautorizuar i cili ka bërë një investigim, hulumtim i cili më pas i ka paraqitur prokuroria si prova të nxjerrura ligjshëm. Prej fillimit të procedurës propozimi i mbrojtjes ka qenë që provat e propozuara për administrim të konsiderohen si të paligjshëm, të nxjerrura nga qytetari Z.V, prandaj propozon që të njëjtat të shpallen si të pa pranueshme. Nëse gjykata i vlerëson ato prova andaj duhet te pasur parasysh se këto prova paraqesin komunikimin ndërmjet qytetares A.K dhe dëshmitarit Z.V i cili pas fotografimit të një kopje të aktakuzës ia dërgon A.K ku i thot se “ e fotografova aktakuzën ndoshta të vyn” dhe përgjigjja e A.. ishte “ sem vyn sen”. Me aktakuzën i mbrojturi i tij akuzohet se si person zyrtar dhe gradimi i tij si rreshter thuhet se ka pas qasje në bazë të detyrës së tij në informacion, pastaj se këtë informacion e ka keqpërdorur si informatë zyrtare. Në elaborimin e fjalës së vet përfundimtare prokurori shpjegon se nuk ka marr atë informacion në data bazë të policisë së Kosovës për të dëmtuarin D.H dhe se këto informacione ia jep qytetares A.K e ky pikërisht nga provat e nxjerra në mënyrë jo të ligjshme vërtetohet se A.K paraprakisht ka pas informacione lidhur me D.H. Se i akuzuari nuk ka pas qasje në data bazë vërtetohet edhe në bazë të deklaratës së ekspertit dhe raportit aq më tepër kur nga raporti i policisë për kaluarën kriminale për të dëmtuarin rezulton se në vitin 2015 D.H ka pasur në evidencë vetëm tri rase dhe numri i imagjinuar 37 nuk ka pasur asnjëherë. Sa i përket raportit në mes të A.. dhe të dëmtuarit D.H duhet të vlerësohet deklarata e saj e cila ka shpjeguar çfarë raporte ka pas me D.. .

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

---

I akuzuari është duke punuar në Stacionin Policor “...” në ..., me gradë rreshterë. Dëshmitaren A.K e njeh nga fqinjësia e poashtu ka qenë edhe kandidatë në auto – shkollë “...” të cilën e mban bashkëshortja e tij, ku edhe ai i ndihmon në mësimin e vozitjes të kandidatëve kur ka kohë të lirë. Një ditë deri sa A.. ishte duke vozitur i është ankuar për të dëmtuarin se nuk e le rahat, duke kërkuar prej tij informacion sa herë ka qenë ai i regjistruar për precedentë në polici. Në atë kohë A.. ka qenë studente dhe si përfaqësuese në Këshillin e studentëve ka marr pjesë në organizimin e protestave dhe aktiviteteve të tjera të partisë ... , ku ka qenë anëtare, e në të cilat aktivitete ka marr pjesë edhe i dëmtuari. Ata kanë vazhduar të shoqërohen edhe për një periudhë kohore kur i dëmtuari ka shprehur ndjenja dashurie ndaj saj, madje aq sa ka shkuar tek prindi i saj në lokal ku ai punon për të pyetur për A... Mirëpo A.. është interesuar në polici dhe ka kuptuar se i akuzuari D.H është i evidentuar si kryes i veprave penale, e për të vërtetuar këtë informacion ajo ka kërkuar prej tij ( të akuzuarit) që të informoj sa herë ka qenë i evidentuar si kryes i veprave penale dhe të kundërvajtjes. I akuzuari me anë të mesazheve përmes “viber” e ka informuar të dëmtuarën me një numër 37 . Këtë informacion dëshmitarja A.. ia ka përcjellë Z.V , i cili është shokë i përbashkët i tyre , i cili pas marrjes së informacionit ka hulumtuar se prej kujt A.. ka marr këtë informacion dhe pasi ka kuptuar se ka marr prej të akuzuarit N.B, këtë njoftim ia ka përcjellë të dëmtuarit D.H ndërsa ky, si kompensim për punën e kryer, Z.V dhe dy shokëve të tij u ka paguar nga 400 €.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratës së të akuzuarit, deklaratës së dëmtuarit D.H, dëshmitarëve A.K dhe Z.V , deklaratën e ekspertit H.Ll dhe provat materiale , raporti i MUB – Policia e Kosovës.

I akuzuari N.B në mbrojtjen e vet duke mohuar kryerjen e veprës penale ka deklaruar se është punëtor pranë Ministrisë së Punëve të Mbrendshëm, punon si oficer pranë Stacionit Policor “...” në ... në cilësinë e mbikëqyrësit të sektorit .... Aty punon nga janari të vitit 2002 ndërsa prej vitit 2004 është me gradë rreshter . Dëshmitaren A.K e ka fqinjë, e njeh edhe prindërit e saj dhe kanë hyrje dalje familjare. Pasi që bashkëshortja e tij është pronare e një auto shkolle dhe poliklinike që merret me lëshimin e certifikatave të gjendjes shëndetësore për punësim, për aplikimin e marrjes së patentë shoferit A.. ka qenë kandidatë në këtë shkollë. Gjatë orëve të vozitjes ka ndodhur që jashtë orarit të punës e ka ushtruar A.., ashtu që gjatë vozitjes A.. ka hapur bisedën rreth marrëdhënieve të cilat ka pas me të dëmtuarin D.H. Është e vërtet se A.. i ka treguar për problemet të cilat i ka me D.., i ka treguar se ai e ngacmonte, provokonte prandaj ka kërkuar zgjidhje rreth këtij problemi. Para se të fliste me të ka biseduar edhe me zyrtarin policor K.I. A.. ka pas një zhgënjim në punën e policisë, gjykatës dhe prokurorisë, në fakt ka konsideruar se nuk kishin ndërmarrë asgjë në drejtim që personi D.H t'i ndërpriste ngacmimet ndaj saj. Pasi që është në pozitën e mbikëqyrësit të sektorit dhe të gjitha lëndët kalojnë edhe përmes dorës së tij që nënkuptohet se duhet të kontrollojë apo të vendosë për një çështje edhe pse për dërgimin e çështjes “kallëzim penal “ vendos udhëheqësi i hetimeve, ashtu që pasi është njoftuar për faktin se D.. ishte i dyshuar për kryerjen e shumë veprave penale, i cili fakt ka rrjedh nga dosja e tij kriminale, ka njoftuar A.. vetëm për qëllim të mirë e jo të diskreditojë personalitetin e të dëmtuarit dhe jo me qëllim që të përfitojë ndonjë gjë nga kjo . Kjo informatë nuk ka qenë publike sepse A.. e ka njoftuar përmes “Viberit” të saj. Nuk ka pasur informacione se A.. ka pasur ndonjë lidhje dashurie me D.H sepse ajo ka treguar se D.. po e ngacmon dhe provokon në mënyra të ndryshme, por bindja e të dëmtuarit ka qenë se me veprimet e tij ka ndikuar në prishjen e raporteve të D.H me A.. .

I dëmtuari D.H ka dëshmuar se A.. e ka njohur në fillim të vitit të kaluar respektivisht në muajin tetor të vitit 2014. Në fillim diçka ka qenë spontane e më pas sipas mendimit të tij ka ekzistuar pëlqim nga të dy anët e pas 8 muajve ka shkuar tek babai i saj dhe nga ai ka kërkuar

që të fejohej me vajzën e tij . I njëjti nuk i ka dhënë kurrfarë përgjigje duke i thënë se duhet të konsultohet me gruan e tij edhe me vajzën. Të nesërmen në orët e pasdites A.. i ka dërguar mesazhet duke i thënë që ka ardhur një njeri i anës së tij dhe i ka treguar që është mafiozë, merret me shitjen e armëve, të drogës dhe është kryes i veprave dhe në përgjithësi është njeri i rrezikshëm dhe kjo ka qenë arsyeja që ajo nuk ka dashur të kontaktonte më me të dhe kjo ka qenë kontakti i fundit me A.. dhe babanë e saj. Ka tentuar në çdo formë të kontaktoj me ta por ka qenë e pamundur. Ka pas bindje që dikush ka ndërhyrë në këto raporte por në fundë ka thanë që me zor nuk shkon marrëdhënia ashtu edhe ka heq dorë. Mirëpo ata tani nuk e kanë lënë rahat në mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar pozitën e tij dhe duke urdhëruar policët të tjerë kanë filluar që të ndalojnë në rrugë me dyshim se automjetin e ka të falsifikuar edhe pse automjeti ka qenë i regjistruar në emër të babet mirëpo në momentin kur është gjetur automjeti iu kishte skaduar regjistrimi. Në këtë drejtim i ka ndihmuar shoku Z.V, i cili njëkohësisht është edhe kolegu i fakultetit i A.. dhe gjatë bisedës ndërmjet tyre ka kuptuar se A.. disponon me informata mbi të kaluarën kriminale të tij dhe më vonë ka marr vesh se këto informata i ka siguruar nga i akuzuari N.B, kjo sepse A.. prej tij ka pranuar mesazh përmes viberit dhe ashtu ka kuptuar për dosjen e tij dhe kjo ishte arsyeja për ndarjen nga ai. Se ai ka pas qëllim që të fejohej me A.. është edhe fakti se ka marr kredi për fejesë dhe martesën me A... Konsideron se informacion të cilën e ka siguruar prej N.B ka qenë edhe arsyeja dhe shkaku i ndarjes andaj rastin e ka paraqitur në Inspektoratin policor dhe veprimet e mëparshme të akuzuarit dhe disa zyrtarëve tjerë L.Th, A.K të cilët i kanë ndalë në shumë raste dhe e kanë maltretuar me pretekst të ndryshme se kinse drejton automjetin e falsifikuar dhe arsye të tjera.

Dëshmitarja A.K ka dëshmuar se është studente, jeton në Lagjen “...” dhe me të akuzuarin janë fqinjë dhe kanë hyrje dalje familjare. Të dëmtuarin D.H e ka njohur gjatë aktivitetit sepse ajo është përfaqësuese në këshillin studentor kurse ai ka qenë anëtar i ..., kanë pas kontakte shkuarjen në protestat e ... në Prishtinë dhe disa veprime të tjera. Kjo shoqëri ka qenë në një periudhë 2 – 3 muaj dhe nuk i ka dhanë D.. ndonjë shkasë mirëpo i njëjti ishte dashuruar në te ashtu që pa dijeninë ka shkuar në lokalën e babait të saj dhe ka kërkuar që të fejohej por babai pas bisedës me të ka refuzuar të njëjtin dhe i ka ndërprerë kontaktet me D.. edhe pse ai ka vazhduar të ngacmon për një kohë të gjatë. Gjatë muajit tetor – nëntor të vitit 2015 është regjistruar në auto shkollën “...” ku pronare është bashkëshortja e të akuzuarit dhe se gjatë ushtrimeve, në një moment ka vërejtur të dëmtuarin D.H i cili ka qenë duke vozitur automjetin e vet dhe duke shikuar përmes dritares së hapur në drejtim të saj, kur ajo i ka treguar N.. se ai është personi i cili nuk po e lë qetë. Pas kësaj N.. është informuar se personi në fjalë sapo kishte dalë nga burgu. Atëherë e ka pyetur N.. pse policia nuk merr masa ndaj një personi siç është D.. i cili drejton automjetin pa patentë shoferi dhe pa tabela. Pandërprerë ajo ka marrë informacione nga disa shokë të D..së se D.. është djali i mirë, posaçërisht Z.V dhe disa persona të tjerë i kanë treguar ashtu, ndërsa në anën tjetër e ka ditur që D.. ka qenë njeri problematik prandaj edhe ka lutur N.. që t’i japë informacion vetëm sa i përket numrit të veprave penale që i ka D... N.. përmes “Viberit” i është përgjigjur se D.. i kishte 37 vepra penale. Qëllimi për sigurimin e informacionit për të kaluarën e D.. ka qenë që t’ia mbyll gojën Z.V, shokut të D.., sepse ai ka folur fjalë të mira për D..

Dëshmitari Z.V ka deklaruar se pas zgjedhjeve parlamentare studentore A.K e ka njoftuar me D.H. Pas një jave, ka vërejtur se lidhja në mes të A.. dhe D.. si çift, ka qenë për çdo lakmi dhe lëvdatë sepse asaj nuk i ka munguar asgjë nga ana e D.. ashtu siç ka treguar vet. Deri sa kanë qenë në lidhje A.. i ka thanë D.. se dikush nga zyrtarët, pa e përmendur emrin, paska biseduar me babanë e saj dhe i ka përmendur disa fjalë të cilat nuk i përkasin D.., të cilat zyrtarë babai i A.. i ka besuar, ashtu që kjo ishte shkaku i shkëputjes së lidhjes në mes tyre. Në

atë kohë A.. ka komunikuar me te përmes facebook, me telefon dhe janë takuar, por kur D.. për herë të dytë është burgosur ka dashur të kuptoj se çka po ndodh me D.., A.. i ka treguar se D.. është kriminel sipas të dhënave që i ka marr nga ky zyrtar dhe se ka shkëputur lidhjen me të derisa ka qenë në burg. Kur ka dashur ta kuptonte arsyen e ndarjes ajo përmes “viberit” i ka dërguar mesazhin nga ky zyrtar me emër N.. polici, të cilat mesazhe i ka printuar duke kërkuar paraprakisht prej D.. aktakuzën pse dy herë ka hyrë në burg dhe pasi D.. ia dërgoi aktakuzën apo procesverbalin, ai i ka printuar kopjet. Në atë kohë D.. ka qenë gati për fejesë dhe ka marrë kredi për këtë, sipas tij dhe tërë shoqërisë, kemi ditur se ata kanë lidhje dashurie. Kur D.. ka përfunduar në burg ai dhe disa shokë janë interesuar për të dhe lidhur me këtë i ka treguar se kanë pasur shpenzime, andaj D.. secilit i ka paguar nga 400 €, në emër të veturave që kanë marr nga “...”, me qëllim që të zbulojnë rastin, në atë kohë, shkurt apo mars të viti 2016, ka ndërprerë punën në “...”. Se D.H ka 37 vepra për kundërvajtje ka kuptuar në bazë të mesazhit që i ka dërguar A.., nuk e di kur ka ardhur deri te shkëputja e lidhjes në mes tyre, pas dërgimit të këtij dokumenti apo përpara, ashtu ai në çdo mënyrë është munduar të ndreqë raportet në mes tyre dhe në mes tjerash A.. i ka dërguar aktakuzën se D.. është i pastër dhe është futur në burg pa faj.

Dëshmitari zyrtari ligjor i Policisë së Kosovës Q.H ka dëshmuar se zyrtari ligjor si nocion , në aspektin policor hyjnë edhe dhënat që mblidhen për qytetarët që janë ndesh me ligjin, që janë të vendosura në data bazë respektivisht në sistemin informativ të Policisë së Kosovës . Gjatë punës din se mbanë dy lloj informacionet që dyshohet që kanë kryer veprën penale dhe informacionet inteligjente që nuk janë në domenin e çdo personit zyrtarë por është një grup i vogël i zyrtarëve policor që kanë qasje në to. Të gjithë zyrtar të cilit punojnë në zyrën ligjore janë kompetent për dhënien e informacioneve sipas kërkesës ndërsa ai si shefi i zyrës e kontrollon dhe i autorizoj që të shkojnë më tutje sipas procedurës dosja ligjore është të gjitha kërkesat që vijnë nga qytetarët që kanë kërkuar marrjen e vërtetimit për të kaluarën kriminale dhe të cilat kanë pas së paku një raste në policin e Kosovës. Qytetari vet kërkon apo me autorizimin e noterit vërtetimin për qytetarin tjetër.

Ekspteri H.L ka deklaruar se punon në Policinë e Kosovës, Drejtoria ... administratori bazë i të dhënave të sistemit informativ, prej vitit 2009, në kuadër të këtij sistemit policia mbledh të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me incidente, aksidente, kundërvajtje në trafik, urdhëresat e gjykatave, veprat penale etj. Në çdo Stacion Policor, regjion, njësi, drejtori janë caktuar personat përgjegjës të cilët e bëjnë evidentimin e këtyre të dhënave. Këto të dhëna nuk janë publike dhe vetëm personi i autorizuar nga ana e Institucionit Policisë ka qasje në këto evidenca. Në bazë të pozitës dhe detyrave që ushtron një zyrtar policor ka të drejtë të përdorë sistemin e data bazës mirëpo sa i përket të akuzuarit nuk ka bërë verifikimin në sistem a ka pas qasje apo jo dhe çdo veprim të cilën e ndërmer personi në sistem bëhet evidentimi i veprimeve duke lënë gjurmën. Pas verifikimit duke vepruar në bazë të urdhëresës së gjykatës është përpiluar raporti dhe është konstatuar se i akuzuari N.B nuk ka pas qasje në sistemin informativ të policisë për periudhën e kërkuar. Në raport janë emrat e pjesëtareve të policisë të cilat kanë kontrolluar apo ndryshuar të dhënat e D.H ka shtuar se çdo ndërhyrje në sistem, kontrollim, fshirje , azhurim , ndryshim ruhet në sistem, ruhet vlera paraprake dhe vlera e re e futur në sistem, koha data llogaria zyrtare dhe emri i zyrtarit, nëse ai vet si administratori i bazës të të dhënave kontrollon, modifikon, ose fshinë ndonjë të dhënë evidentohet që e ka bërë .

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit N.B dhe provat e administruar e duke pasur parasysh tërë zhvillimin e ngjarjes ka ardhur në përfundim se nuk janë kontestuese faktet se i akuzuari është personi zyrtar dhe punon pranë Stacionit Policor “...” në ..., se A.. e njeh si fqinje, se ka qenë e regjistruar si kandidate pranë auto – shkollës “...”, pronara e të cilës është

bashkëshortja e tij, se kohën e lirë edhe ai ndihmon në ushtrimin e kandidatëve pranë kësaj shkolle, se A.. dhe D.. janë shoqëruar për një periudhë kohore, se D.. shprehte ndjenja dashurie ndaj saj, se pas një kohe raportet e tyre janë çrregulluar dhe se përmes faqes “viber” ia ka dërguar A.. mesazhin me numër 37, se këtë mesazh A.. i ka përcjellë dëshmitarit Z.V i cili është shoku i sajë dhe D.., se Z.V ka hulumtuar se nga ka rrjedhë ky informacion me nr. 37 duke e vërtetuar se burimi i informacionit ka qenë N.B dhe për këtë fakt e ka informuar D...

Mirëpo, sipas konstatimit të gjykatës ,se i akuzuari N.B , si person zyrtar ka dërguar mesazh “37” përmes faqes “Viber” dëshmitares A.K, i cili mesazh ka qenë lidhur me të dëmtuarin D.H dhe të kaluarën e tij kriminele, nuk paraqet shkakun i cili ka ndikuar që të ndërpritet lidhja në mes të dëmtuarit D.H dhe dëshmitares A.K, kjo duke patur parasysh se pasojës – shkëputja e lidhjes kanë paraprirë disa kushte sepse para se të gjithash kur kemi parasysh se dëshmitarja A.. ka deklaruar se me të dëmtuarin është njoftuar diku në fillim të vitit, se lidhja e tyre ka zgjatur për disa muaj, në fakte deri në muajin prill, se nëndërkohë ka vërejtur disa sjellje jo të zakonshme nga ana e tij, se është interesuar për personalitetin e tij edhe te disa policë të tjerë dhe se si arsye pse prej të akuzuarit ka kërkuar informacione, ka qenë vetëm për të mbyllur gojën disa personave të cilit kanë pasur fjalë të mira për të dëmtuarin D.. Prandaj sipas mendimit të gjykatës ai mesazh të cilin i akuzuari ia ka dërguar kësaj dëshmitareje nuk është shkak i drejtpërdrejtë i shkëputjes së lidhjes në mes asaj dhe të dëmtuarit, ashtu që në mes të veprimin dhe pasojës të shkaktuar nuk ekziston lidhja kauzale, atëherë nuk ekziston as vepra penale.

Në anën tjetër, sipas mendimit të gjykatës gjendja faktike nga të dhënat nga akuza nuk mund të përfshihen nën përshkrimin e veprës penale të keqpërdorimit të informatës zyrtare me të cilën vepër ngarkohet i akuzuari. Në fakt, përshkrimi ligjor i kësaj vepre penale parasheh se personi zyrtar me qëllim që vetes apo tjetrit të përfitojë ndonjë përparësi (çfarëdo çoftë ajo) materiale apo jo materiale dhe me dhënien e informacionit është kontribuar që ky qëllim të realizohet. Në rastin konkret nuk është vërtetuar se kush ka përfituar ndonjë përparësi,

Nga përshkrimi i dispozitës ligjore të kësaj vepre penale, në rastin konkret raporti në mes të dëmtuarit dhe dëshmitares nuk mund të konsiderohet si raporti juridik, andaj gjykata konsideron se nuk ka pasojë ligjore të paraparë me dispozitat e përmendura. Një informatë për të qenë e rëndësishme për ndonjë raport juridik, duhet analizuar se çfarë nënkupton raporti juridik. Sipas mendimit të gjykatës në krijimin e raporteve juridike dhe formimin të tyre duhet krijuar një lidhje në mes të normës juridike dhe të raportit, dmth. raporti juridik nuk mund të formohet nëse nuk është i paraparë me normë juridike, pra ai formohet kur plotësohen kushtet e caktuara në bazë të normave të përcaktuara me ligj.

Prandaj, nga të gjithë të cekurat më lartë gjykata ka ardhur deri te konkluzioni se në veprimet e të akuzuarit nuk formohen elementet veprës penale për të cilën akuzohet dhe të njëjtin e ka liruar nga akuza në bazë të nenit 364 par.1 nënpar. 1.1 KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 454 par. 1 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pronësore-juridike është marrë në bazë të dispozitës së nenit 463 par.3 të KPP.

Nga se u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**P.nr. 194/2016 me datë 20.11.2017**

**Sekretarja juridike,**  
**Valdete Zurnaxhiu**

**Përkthyesi gjyqësor**  
**Asnije Berisha**

**Kryetarja e trupit gjykues**  
**Raima Elezi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,e nëpërmjet të kësaj gjykate.